

Lëvizja FOL
Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2020

PËRMBAJTJA:

Opinioni.....	1-3
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse.....	4
Bilanci i pozitës financiare.....	5-6
Pasqyra e rrjedhës së parasë.....	7-8
Shënimë shoqëruese të Pasqyrave financiare.....	9-12
Shënimë mbi Pasqyrat financiare.....	13-24

Raporti i Audituesit të pavarur mbi auditimin e pasqyrave financiare

Lëvizja FOL

Bordit Këshillëdhënës

Andrea Gropa nr.35

Prishtinë

Opinioni

Kemi audituar pasqyrat financiare të Lëvizja FOL, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2020, pasqyra e të ardhurave dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë një përbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Lëvizja FOL me 31 dhjetor 2020, të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë dhe janë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe Ligjin 06/L-43 „Për lirinë e asocilitët në institucionet joqeveritare”.

Baza për opinionin

Auditimin e kemi kry në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *“Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare”* të këtij raporti.

Jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa.

Besojmë se evidanca e përfthuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë të arsyeshme për opinion.

Theksim i çështjes

Ne térheqim vëmendjen në Shpalosjen *“Parimi i vijimësisë së afarizmit”* (Fq.17.) dhe *“Ngjarjet pas përfundimit të periudhës së raportimit”* (Fq.24) të pasqyrave financiare, që përshkruajnë efektet e përhapjes së pandemisë COVID-19 në vijimësinë e aktiviteteve të tanishme të organizatës dhe në periudhat e ardhshme raportuese.

Opioni ynë nuk është ndikuar nga këto çështje.

Vijimësia

Pasqyrat financiare, janë përgatitë mbi bazën e vijimësisë, drejtimi nuk ka për synim likuidimin as ndërprerjen e veprimtarisë për 12 muajt e ardhshëm.

Auditimi nuk ka identifikuar ekzistencën e ngjarjeve apo kushteve të cilat krijojnë dyshime mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësitë e drejtimi dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombe të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për kontolle për të cilat drejtimi mendon se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përvèç nëse drejtimi ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përvèç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e audituesit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përfitojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare, si tërsi, nuk përbajnjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është siguri absolute se auditimi i kryer sipas Standardeve Ndërkombe të Auditimit gjithmonë do të zbulojë anomali materiale në rast se ato ekzistojnë. Anomalitë mund të paraqiten si rezultat i mashtrimi ose gabimit dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, mund të ndikojnë në vendimin që marrin përdoruesit duke u bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me Standardeve Ndërkombe të Auditimit, ne kemi ushtruar gjykimin profesional dhe kemi ruajturë skepticismin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu jemi përgjegjës të:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, organizojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqueve dhe përfitojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbështetjen e opinionit tonë. Rreziku i mosbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, mospërfshirjen e qëllimshme dhe keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.

Përfitojmë njohuri mbi kontrolllet e brendshme që janë të rëndësishme për auditimin në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.

Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga drejtimi.

Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e hipotezës së vijimësisë e përdorur nga ana e drejtit të bazuar nga evidenca e përfituar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të

vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të térheqim vëmendjen në raportin e auditimit, në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit, mirépo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjen, nëse pasqyrat financiare përfaqësojn transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrihet paraqitja e drejtë.

Me personat e ngarkuar me qeverisjen, kemi komunikuar, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësie domethënëse në kontrollin e brendshëm të identikuara gjatë auditimit tonë.

Prishtinë 07.06.2021.

Audit Office Shpk

Ulpiana D1/7 H8, Prishtinë

Shaban Muharremi

Auditor Ligjor,

044 112-036.



Lëvizja FOL

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Për 01.01- 31.12.

Në €.	Notat	2020	2019
<i>Të hyrat</i>			
Donacionet	1	249,448	145,393
Te hyrat tjera	2	5,482	2,218
Të hyrat e shtyra	3	-97,985	-34,600
<i>Totali i të hyrave</i>		156,946	113,011
<i>Shpenzimet</i>			
Programet	4	67,581	28,572
Grantet	5	10,757	-
Personeli	6/1	54,394	58,554
Administrata	6/2	24,214	25,885
<i>Totali i shpenzimeve</i>		156,946	113,011

*Fitimi/Humbja***Shpenzimet tjera***Fitimi/humbja neto*

Lëvizja FOL**Bilanci i pozitës financiare****31.Dhjetor**

Në €	Notat	2020	2019
I. Pasurivje			
A. Afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	90,812	34,767
Llogarit e arkëtueshme nga grantet	8	7,441	-
Totali i pasurive afatshkurtra		<u>98,253</u>	<u>34,767</u>
B. Afatgjata			
Pasurit dhe Pajisjet		-	-
Totali i pasurive afatgjata		-	-
Totali i pasurive A+B		<u>98,253</u>	<u>34,767</u>
II. Detyrimek			
A. Afatshkurtra			
Të pagueshme	9,10	268	168
Te Hyrat e Shtyra	3,11	97,985	34,600
Totali i detyrimeve afatshkurtra		<u>98,253</u>	<u>34,767</u>
B. Afatgjata			
Lizingu,Huamarrjet, Provizonet, tjera		-	-

Lëvizja FOL**Bilanci i pozitës financiare-vazhdim**

Totali i dotyrrimeve njeftojteta

Totali i dotyrrimeve AAK

38,767

II - Kapitali**Hapja fillestare**

Totali i kapitalit

38,767

Kapitali & Dotyrrimet**Mexhide Demolli-Nimani, Drejtore Ekzekutive**

Lëvizja FOL

Pasqyra e rrjedhës së parasë

Në €

I RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE:

Të hyrat e shtyra +/-

Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave

Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve

Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve

Amortizimi i pasurive të paprekshme

Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme

Ndryshimi i vlerës së pronës investuese

Të ardhurat financiare MINUS

Shpenzimet financiare

(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve +/-

Shpenzimet e tatimit në fitim

	2020	2019
	63,386	2,166

-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-
-	-	-

Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative

(Rritja)/zvogëlim në llog. e arkët.tregtare dhe të tjera

(Rritja) / zvogëlimi në llogaritë e pagueshme

(Rritja) / zvogëlimi në tatimet dhe pensionet e pagueshme

Rritja/(zvogëlimi) në të hyrat e shtuara

Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera

-7,441	4,982
100	(1,926)
-	-
-	-
-	-
-	-
-7,341	3,056
-	-
-	-
-	-
56,044	5,222

Tatimi në fitim i paguar

Interesi i paguar

I RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIV. OPERATIVE**II RRJEDHA E PARASË NGA AKTIV.I INVESTUESE**

Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve

Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve

Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme

Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme

Interesi i arkëtar

Dividendat e arkëtuara

II RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIV.I INVESTUESE**III RRJEDHA E PARASË NGA AKTIV.FINANCUESE;**

Deponimet e kapitalit shtesë

-	-
-	-
-	-
-	-
-	-
-	-
-	-
-	-
-	-
-	-

-	-
---	---

Lëvizja FOL

Pasqyra e rrjedhës së parasë-vazhdim

Në €

Dividendat e paguara

Arkëtimet nga kreditë dhe huatë

Ripagimi i kredive dhe huave

Pagesat e lizingut finansiar

III RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIV.FINANCUESE

-	-
-	-
-	-
-	-
-	-

RRITJA/(ZVOGLIMI)NETO I PARASË DHE EKUIVALENTËVE TË PARASË

56,044 5,222

PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË NË FILIM TË VITIT

34,767 29,545

PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË NË FUND TË VITIT

90,812 34,767

Lëvizja FOL**Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare**

Të hyrat totale në €	2020	2019
1. Donacionet	214,849	317,941
TEAM DAI Global LLC	26,072	25,077
CILC-Promoting integrity in the judiciary	-	11,114
Kosovo Foundation for Open Society - KFOS	13,000	39,775
Kosovar Civil Society Foundation		
KCSF	31,690	3,500
BIRN	-	1,735
Royal netherlands embassy	75,710	14,277
KAS Prishtina	3,260	-
Communic.for Social Development		
CSD	3,280	2,391
Friedrich-Ebert-Stiftung	5,300	2,510
Instituti Demokratik i Kosovës	-	6,130
JSSP (BIRN		
)	19,499	3,603
US		
Embassy	32,039	7,830
Publish What you Pay	4,999	-
2. Të hyrat tjera	5,483	2,218
Lëvizja Fol	1,493	116
Program income-Debate Center	3,990	2,102
3. Të hyrat e shpyrta	97,985	34,600
Të hyrat e pasfrytëzuara neto	97,985	34,600

Lëvizja FOL

Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare-vazhdim

	2020	2019
4. Shpenzimet Programore:		
Kostot direkte		
Programore	52,216	22,210
Konsulentët, përkthimet	13,551	5,065
Udhëtimet	1,813	1,298
Shpenzimet Totale Programore	67,581	28,572
5. Grantet e dhama:		
Partnerave ne projekte	10,757	-
Totali i granteve	10,757	
6. Shpenzimet operativë:	78,608	84,439
6/1 Personeli	54,394	58,554
Shpenzimet e Personelit	54,394	58,554
6/2 Shpenzimet Administrative	24,214	25,885
Provizioni bankar	439	414
Sherbimet profesionale	394	4,946
Transport	45.44	87
Për zyre	2,763	2,422
Qiraja	15,305	13,200
Rryma, uji, pastrimi	2,582	2,017
Mirmbajtje	457	95

Lëvizja FOL

Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare-vazhdim

Sigurimi (alarmi)	360	540
Auditimi	700	700
PTT,tel, internet	973	1,365
Antarësit	-	100
Printim	195	-

7. Paraja dha equivalentet e parashë

	31-Dec-2020	31-Dec-2019
PCB - 1110310629010195	80,883.22	33,834.63
PCB - 1110310629030177	549.66	678.69
PCB - 1110310629000107	68.64	101.31
PCB - 1110310629070141	8,359.11	-
PCB - 1110310629020186	150.00	-
Arka	801.13	152.80
Total paraja:	90,811.76	34,767.43

8. Illogarit e arkëtueshme nga grantet

Grantees Advance Payments	7,441	4,982
---------------------------	-------	-------

9. Illogarit e pagueshme

Për shërbime	118	122
--------------	-----	-----

10. Detydimet viktivitare

Pagat, TMB të pagueshme	150	46
-------------------------	-----	----

Lëvizja FOL**Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare-vazhdim**

II. Mapja fillosteare 01.01.	19,750
11/1 Paraja:	
Banka	34,767
Arka	34,615
11/2 Llogarit e arkëtueshme:	153
	4,982

Informata të përgjithshme dhe struktura qeverisëse

Sipas marëveshjes së angazhimit të nënshkruar me Lëvizjen FOL, kemi bër auditimin e pasqyrave financiare për periudhën që përfundon më 31 dhjetor 2020.

Lëvizja FOL është e regjistruar si organizatë joqeveritare sipas Ligjit Nr.06/L43 "Për lirinë e asocimiit në institucionet joqeveritare" me Nr.regjistri 5112424-3 nga 25.06.2009, dhe posedon NF600186862.

Emri i plotë është "Lëvizja FOL" emir i shkurtë" FOL".

Statuti i Organizatës përcakton këtë strukture të qeverisjes:

1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës dhe përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës.
2. Bordi Këshillëdhënës themelohet për të kontribuar dhe mbështetur organizatën në procesin vendimmarrës.
3. Drejtori Ekzekutiv i zgjedhur nga Kuvendi i Antarëve është përfaqësues i organizatës dhe vepron në emër të organizatës.

Aktivitetet specifike dhe fushat e ekzamínimit

Objektiv i organizatës është:

Mbështja e qytetarëve, rritja e transparencës dhe llogaridhënieve e institucioneve publike me qëllim të mundësimit të një qeverisjeje të mirë dhe pa korruptionit.

Transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve publike në Kosovë, është synimi dhe angazhimi kryesor i Lëvizjes FOL.

Aktivitetet kryesore në arritjen e objektivit janë në formën e :

- Konferencave, seminareve, tryezave dhe takimeve;
- Puntori dhe trajnime;
- Publikime, hulumtime dhe përkthimi i materialeve;
- Advokimi dhe mbështetje teknike;
- Monitorime;

Adoptimi i Standardeve të Raportimit të reja ose të rishikuara dhe Interpretimeve

Ndryshimet në SNRF 3 “Përkufizimi i një biznesi”

Ndryshimet në SNRF 3 ishin efektivisht të detyrueshme për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020.

Subjekti si OJQ kishte parasyshë përkufizimin e rishikuar të një biznesi për blerjet që ndodhin në ose pas 1 Janarit 2020 në përcaktimin nëse një blerje llogaritet në përputhje me SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*. Ndryshimet nuk lejojnë që subjekti të rivlerësojë nëse blerjet e ndodhura para 1 Janarit 2020 përmbrushën përkufizimin e rishikuar të një biznesi.

Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 “Reforma e Referencës së Normës së Interesit” - ‘faza 2’ e IBOR.

Këto ndryshime në disa standartet të SNRF janë efektivisht të detyrueshme për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, megjithatë, subjekti si OJQ i ka shqyrtau ato para hyrjes në fuqi të tyre, pra për periudhën aktuale të raportimit. Këto ndryshime modifikojnë kërkesat specifike të kontabilitetit mbrojtës për të lejuar kontabilitetin mbrojtës të vazhdojë për mbrojtjet e prekura gjatë periudhës së pasigurisë përpara se elementët e mbrojtur ose instrumentet mbrojtës të prekur nga referencat aktuale të normave të interesit të ndryshohen si rezultat i reformave në vazhdim të referencës së normës së interesit.

Ndryshimet nuk janë të rëndësishme për subjektin duke qenë se nuk zbaton kontabilitetin mbrojtës për ekspozimet ndaj normave të interesit.

Ndryshime në SNRF 16 “Koncesionet e Qirave që lidhen me COVID-19”

Duke filluar nga 1 qershor 2020, SNRF 16 u ndryshua për të siguruar një mjet të përshtatshëm praktik për qiramarrësit që kontabilizojnë koncesionet e qirasë që lindin si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë COVID-19 dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Ndryshimi në pagesat e qirasë rezulton në konsideratë të rishikuar për qiranë që është në thelb e njëjtë me, ose më pak se, pagesën për qiranë menjëherë para ndryshimit;
- Reduktimi në pagesat e qirasë ndikon vetëm pagesat që u paguan fillimisht më ose para 30 Qershorit 2021; dhe
- Nuk ka asnje ndryshim thelbësor në termat dhe kushtet e tjera të qirasë.

Koncesionet e qirasë që plotësojnë këto kritere mund të llogariten në përputhje me qëllimin praktik, që do të thotë që qiramarrësi nuk vlerëson nëse koncesioni i qirasë përmbrush përkufizimin e një modifikimi të qirasë. Qiradhënësit zbatojnë kërkesa të tjera në SNRF 16 në kontabilitetin për koncesionin.

Subjekti si OJQ ka zgjedhur të përdorë mjetin e përshtatshëm praktik për të gjitha koncesionet e qirasë që plotësojnë kriteret. Përmirësimi praktik është zbatuar në mënyrë retrospektive, që do të thotë se është aplikuar për të gjitha koncesionet e qirasë që plotësojnë kriteret, të cilat në rastin e subjektit, ndodhën nga Marsi 2020 deri në Qershor 2020.

Kontabilizimi i koncesioneve të qirasë si modifikime të qirasë do të kishte rezultuar që subjekti të rimatë detyrimin e qirasë për të pasqyruar shumën e rishikuar duke përdorur një normë të rishikuar të skontimit, me efektin e ndryshimit në detyrimin e qirasë të regjistruar ndaj pasurisë me të drejtë përdorimi. Duke zbatuar mjetin e përshtatshëm praktik, subjektit nuk i kërkohet të përcaktojë një normë të rishikuar të skontimit dhe efekti i ndryshimit në detyrimin e qirasë

Adoptimi i Standardeve të Raportimit të reja ose të rishikuara dhe Interpretimeve-vazhdim pasqyrohet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ndodh ngjarja ose kushti që shkakton koncesionin e qirasë. Subjekti nuk kishte ndonjë koncesion qiraje që lindte si pasojë e drejtëpërdrejtë e pandemisë COVID-19 dhe për këtë arsyë ndryshimi në SNRF 16 nuk pati ndonjë efekt në pasqyrat financiare të subjektit.

Standardet e tjera

Standardet e reja që janë miratuar në pasqyrat financiare vjetore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, por nuk kanë pasur një efekt të rëndësishëm në subjektin janë:

- SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet (Ndryshimi - Iniciativa për Shpalosje – Përkufizimi i Materiale); dhe
- Rishikimet e Kornizës Konceptuale për Raportimin Financiar.

Standardet, interpretimet dhe ndryshimet e reja ende jo efektive

Ekzistojnë një numër standardesh, ndryshime në standarde dhe interpretime të cilat janë publikuar nga BSNK që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që subjekti si OJQ ka vendosur të mos i miratojë herët.

Ndryshimet e mëposhtme janë efektive për periudhën që fillon më 1 janar 2022:

- Kontratat me ngarkesë të madhe-Kostoja e Përbushjes së Kontratës (Ndryshimet në SNK 37);
- Prona, impiantet dhe pajisjet: Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16);
- Përmirësimet vjetore të Standardeve të SNRF 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41); dhe
- Referencat në Kornizën Konceptuale (Ndryshimet në SNRF 3).

Në janar 2020, BSNK publikoi ndryshime në SNK 1, të cilat sqarojnë kriteret e përdorura për të përcaktuar nëse detyrimet klasifikohen si qarkulluese ose joqarkulluese. Këto ndryshime sqarojnë se klasifikimi qarkullues ose joqarkullues bazohet në faktin nëse një entitet ka të drejtë në fund të periudhës raportuese të shtyjë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit. Ndryshimet sqarojnë gjithashtu se 'shlyerja' përfshin transferimin e parave të gatshme, mallrave, shërbimeve ose instrumenteve të ekuitetit përveç nëse detyrimi për transferimin e instrumenteve të ekuitetit lind nga një tipar konvertimi i klasifikuar si një instrument i ekuitetit veç e veç nga përbërësi i detyrimit të një instrumenti financiar të përbërë. Ndryshimet fillimisht ishin efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022. Sidoqoftë, në maj të vitit 2020, data e hyrjes në fuqi u shty për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023.

Subjekti aktualisht po vlerëson ndikimin e këtyre standardeve dhe ndryshimeve të reja të kontabilitetit. Subjekti nuk beson se ndryshimet në SNK 1 do të kenë një ndikim të rëndësishëm në klasifikimin e detyrimeve të saj, pasi tipari i konvertimit në instrumentet e saj të borxhit të konvertueshëm klasifikohet si një instrument i ekuitetit dhe për këtë arsyë, nuk ndikon në klasifikimin e borxhit të saj të konvertueshëm si një detyrim joqarkullues.

Të tjera

Subjekti si OJQ nuk pret që ndonjë standard tjetër i publikuar nga IASB, por jo ende efektiv, të ketë një ndikim material në te.

Objktivi dhe karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare

Identifikimi dhe objektiva e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare identifikohen qartë dhe dallohen nga informacionet tjera.

Emri i njësisë raportuese, njësia individuale që mbulohet, periudha e mbuluar, monedha raportuese dhe rrumbullakimi i shumave në euro, janë paraqit dukshëm dhe janë përsërit kur ishte e nevojshme për kuptimin e saktë të informacionit të paraqitur.

Titujt e faqeve dhe titujt e shkurtuar janë paraqit në kolonat e çdo faqeje në pasqyrat financiare.

Efektet financiare të transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera janë paraqit duke i grupuar ato në klasa të gjëra sipas karakteristikave të tyre ekonomike.

Të gjitha zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njoitura gjatë periudhës janë përfshir në fitim, humbje apo të hyra të shtyra.

Nuk kemi dhe nuk kemi paraqit zëra të jashtëzakonshëm të të ardhurave ose shpenzimeve, as në pasqyrën e të ardhurave as në shënimet shpjeguese.

Zërat materiale të të ardhurave dhe shpenzimeve janë paraqit ndaras për nga natyra dhe shuma.

Pasqyrat financiare jepin informacione të mjaftueshme lidhur me gjendjen, rezultatin dhe ndryshimet e gjendjes financiare të dobishme për përdoruesit në marrjen e vendimeve ekonomike, plotësojnë nevojat e përdoruesve dhe pasqyrojnë kujdesin e treguar nga ana e drejtimit për fondet që i janë besuar.

Janë të kuptueshme për përdoruesit me njohuri të arsyeshme për organizatën, veprimtarin dhe kontabilitetin.

Informacionet krahasuese

Nuk ka pasur ndryshme në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, prandaj nuk ka pas nevojë për riklasifikim të shumave krahasuese dhe dhënie të informacioneve shpjeguese.

Mënyra e prezantimit dhe klasifikimit të artikujve në pasqyrat financiare është në përputhje, ajo është e njëjtë nga njëra periudhë në tjetrën dhe vazhdimesh është përdorur një politikë kontabël që zbatohet për çdo kategori.

Deklaratat mbi pajtueshmërinë dhe politikat e rëndësishme të kontabilitetit

Në mungesë të një Standardi ose një Interpretimi që zbatohet veçanërisht për një transaktion, ngjarje apo kusht tjetër, drejtimi ka përdorë gjykimin e tij në zhvillimin dhe zbatimin e politikës kontabël që ka rezultuar në informacionin i cili është i besueshëm.

Për të përbushur detyrimet e kërkuar nga Standardeet e Kontabilitetit, organizata, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme që të shpalos informacionet për të gjitha kërkesat.

Organizata ka mundësi të jap informacione shtesë nëse përputhja me ndonjë kërkesë specifike të Standardeve të Kontabilitetit është e pamjaftueshme.

Në rast nevoje, mundemi me dhanë informacione shpjeguese për natyrën dhe shumën e ndryshimit në vlerësimin kontabël që kan efekte në periudhën aktuale apo kur pritet të ketë efekt në periudhat e ardhshme, përveç rastit të dhënies së informacionit shpjegues të efektit për periudhat e ardhshme kur është i pazbatueshëm vlerësimi i këtij efekti.

Deklaratat mbi pajtueshmërinë dhe politikat e rendësishme të kontabilitetit-vazhdim

Nuk ka pasur ndryshime në vlerësimet kontabël që përfaqëson një rregullim në lidhje me rritjen e një pasurie ose detyrimi që paraqitet si rezultat i një informacioni të ri apo zhvillimeve të reja që nuk janë korrigjime të gabimeve.

Pasuritë dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet janë raportuar ndaras.

Personi i angazhuar në kontabilitetit dhe udhëheqjen e evidenceve, është me provojë të duhur. Evidencat udhëhiqen në formë profesionale mes aplikimit të softwerit “QuickBooks”me hyrje të dyfishtë nga i cili burojn informatat për përpilimin e raporteve financiare.

Deklarata e Pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndermarrjet e vogla dhe të mesme të miratuar nga Këshilli Kosovar i Raportimit Financiar dhe Ligjin 06/L-43 “Për lirinë e asociimit në institucionet joqeveritare”.

Cikli operativ është periudha 12 mujore.

Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të janë të ndryshme nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën çmuarja rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Informacioni mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në Përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Njohja-përfshirja në bilancin e gjendjes ose në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të një transaksiuni është bërë kur ka qen reale se çdo përfitim ekonomik në të ardhmen që lidhet me këtë transaksion do të rrjedhë tek ose nga organizata dhe transaksiuni ka pas kosto ose vlerë që mund të matet me besueshmëri.

Matja është proces i përcaktimit të shumave monetare me anë të të cilave do të njihen dhe barten në bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, element e pasqyrave financiare.

Baza neto e raportimit

Fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup transaksionesh të ngjashme raportohen mbi bazë neto, fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit ose fitimet dhe humbjet nga instrumentat financiare të mbajtur për tregtim.

Megjithatë fitime dhe humbje të tillë kur janë material raportohen ndaras.

Deklaratat mbi politikat e rendësishme të kontabilitetit-vazhdim

Parimi i vijimësisë së afarizmit

Raportet Financiare janë përgatiturë mbi supozimin se organizata ka aftësinë dhe qëllimin që të vijojë dhe se do të vazhdojë të funksionojë në një të ardhme të parashikueshme (se paku 12 muaj) dhe drejtimi nuk ka vërejtë ndonjë vështërësi dhe as nuk ka synim apo nevojë të likuidojë ose të shkurtojë materialisht shkallën e operacioneve të veta.

Duhet cekur se në kohën e autorizimit të pasqyrave financiare për publikun, jemi në kohën e përhapjes së pandemisë COVID-19 prandaj jemi ballafaquar me një situate të re dhe të panjohur deri më tani, kjo na ka detyruar që të bëjmë organizim të ri të punës, ashtu që kemi organizuar punën prej ambienteve shtëpiake kur ka qenë e nevojshme, prandaj pandemia na ka shkaktuar kufizim të lëvizjes por nuk kemi pas dëmtim të pasurive as ndërprerje të aktiviteteve pasi që ato i kemi zhvilluar online duke mbajt kontakte te rregullta me personelin, donatorët dhe organizatat tjera. Zhvillimi i punës është bërë duke respektuar distancën dhe rregullat e Qeverisë.

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve

Pasuritë dhe detyrimet janë paraqit sipas parimit afatshkurtër-afatgjatë;

Detyrimet e mbajtura për qëllime tregtimi janë klasifikuar si afatshkurtëra;

Detyrimi financier që duhet të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve nga data e bilancit, për të cilin organizata nuk ka pas ndonjë të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e tij për të paktën dymbëdhjetë muaj nga data e bilancit, është klasifikuar si detyrim afatshkurtër.

Kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara

Organizata ka përgatitë pasqyrat financiare, duke përdorur kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Materialiteti dhe bashkimi

Mungesa ose deklarime të gabuara të zërave që janë materiale, (nëse në mënyrë individuale ose grupuar mund të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve), nuk ka patur.

Çdo klasë materiale e zërave të ngjashëm është paraqitur e bashkuar në pasqyrat financiare. Zërat që nuk janë të së njëjtës natyrë ose funksion janë paraqit ndaras me përjashtim të rastit nëse janë jo materiale.

Zëri që nuk është individualisht material, është bashkuar me zëra të tjerë në pasqyrën përkatëse dhe është shqaruar në shënimet shpjeguese.

Kompensimi

Pasuritë dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë kompenzuar me përjashtim kur kjo ishte kërkes ose lejohej nga një Standard ose një Interpretim.

Deklaratat mbi politikat e rendësishme të kontabilitetit-vazhdim

Principi akrual (momenti i paraqitjes së transaksionit)

Raportet financiare janë të përgatitura sipas parimit akrual, kjo nënkupton që fondet janë njojur në momentin e pranimit, kurse shpenzimet janë njojur në momentin e ndodhjes, në shumicën e rasteve momenti i ndodhjes është identik me momentin e pagesës.

Parimi akrual bënë të mundshme që efektet e ndryshimeve, qoftë rritja apo zvogëlimi i pasurisë, të njihen që në momentin e shfaqjes së tyre, pavarësisht nga momenti hyrjes apo daljes se parasë.

Personeli-Burimet njerëzore

Evidencat mbi personelin, dokumentacioni personal, është i arkivuar në file të veçantë.

Përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e personelit janë të përshkruara në termat e referencës të bashkangjitura kontratave të punësimit.

Llogarit e arkëtushme dhe llogarit e pagueshme

Llogarit e Arkëtueshme dhe Lloragit e Pagueshme dhe detyrimet tjera të pagueshme janë paraqit me vlerën e tyre reale.

Në raport si llogari të arkëtushme janë rapportuar shumat e donacioneve të papranuara për projektet active.

Obligimet rrjedhëse ndaj furnitorëve për shërbime dhe tatimeve, paraqitetn si Llogari të pagueshme respektivisht si Detyrime afatshkurta.

Pasuritë

Pasuritë janë regjistruar në shumën e parasë ose ekivalentet e saj të paguara ose në vlerën e drejtë të nevojshme për ta blerë në kohën e blerjes.

Ne vitin aktual ka pasur blerje te vogla që nuk janë kapitalizuar.

Raporti Financiar nuk paraqet gjendje financiare të pasurisë, pasi që të gjitha blerjet kan ngarkuar shpenzimet e vitit kur janë blerë, kurse organizata posedon evidencë të inventareve të blera nga mjetet e donacioneve.

Aktivet e paprekshme

Organizata nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori në pasqyrën e pozicionit financiar.

Kapitali

Organizata nuk ka paraqitur pasqyrën e ndryshimeve në kapital neto mes dy datave të bilancit që tregonë rritjen ose pakësimin në aktivet neto të saj gjatë periudhës.

Madhësia e kapitalit të një subjekti dhe se si ai e menaxhon kapitalin janë kushte të rendësishme për shqyrtim nga ana e përdoruesit gjatë vlerësimit të profitit të rrezikut të një subjekti dhe aftësinë e tij për të përballuar ngjarjet e pafavorshme dhe të papritura.

Informatat e dhëna në lidhje me kapitalin është e dobishme për përdoruesit e pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme.

Deklarata mbi politikat e rendësishme të kontabilitetit-vazhdim

Detyrimet e Lëvizjes FOL janë 98,2537€ prej tyre detyrimi ndaj të hyrave të shtyra është 97,985€.

Paraja dhe ekuivalentët e sajë

Paraja e disponueshme është paraqitur në vlera reale në moment, duke filluar nga prania fizike në arkë dhe ato në llogarit bankare.

Krijohen nga hyrjet e parave të gatshme dhe ekuivalenteve të parave.

Kemi llogari bankare bazë të shpenzimeve dhe llogari të të hyrave në PCB.

Pagesat dhe inkasimet janë bërë nga këto llogari bankare.

Pagesat procesohen nga Menaxher i Financave dhe Administrates, pas aprovimit nga Drejtori Ekzekutiv.

Bilanci përbyllës i mjeteve në llogaritë bankare dhe arkë (fq.11) janë konfirmuar nga pasqyra bankare, konfirmimi nga bankat si dhe nga Procesi i regjistrimit të parasë së gatshme në arkë.

Monedha raportuese

Raportet e organizatës dhe të gjitha raportet financiare të publikuara janë shprehur në Eur (€) që njihet si monedha raportuese në Kosovë, kurse konvertimi i valutës tjeter në datën e bilancit është bërë me kursin e fundvitit 31.12.

Transaksionet në monedhë të huaj, rreziku i monedhës

Transakcionet me monedha të huaja këmbehen në Euro (€), duke përdorur kursin e këmbimit të asaj date, diferencat e këmbimit të monedhave të huaja qofshin fitim apo humbje, janë paraqitur automatikisht në pasqyren e të hyrave. Në fund të periudhës, pozicionet monetare janë raportuar duke përdorur kursin e këmbimit të vlefshëm në ditën e fundit të këmbimit.

Rreziku i monedhës paraqet rrezikun që vlera e drejtpërdrejt ose rrjedha e parasë apo ndonjë pasuri monetare në të ardhmen do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

Në raste kur janë paraqitur hyrje të mjeteve në monedha të ndryshme nga Euro, konvertimi është bërë nga banka duke përdorur kursi momental të bankës.

Çdo diferençë këmbimi që rrjedh nga njojja e një zeri monetar me një kurs të ndryshëm nga ai me të cilin është njojur fillimisht gjatë periudhës, ose është njojur në pasqyrat financiare të mëparshme, njihet në fitim ose humbje.

Rrezikut Financiar

Organizata nuk përdor instrumente financiare, prandaj edhe ekspozimi ndaj këtij rreziku është i ulët.

Përndryshi, administrimi i rrezikut finansiar përfshin politikat dhe proceset për pranimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut, të cilat përfshijnë:

Strukturën dhe organizimin e funksioneve të menaxhimit të rrezikut përfshirë edhe trajtimin e pavarësisë dhe llogaridhënie;

Fushëveprimi dhe natyra e sistemeve ose matjes së rrezikut;

Deklarata mbi politikat e rendësishme të kontabilitetit-vazhdim

Proceset për monitorimin e efektivitetit të vazhdueshëm të këtyre masave mbrojtëse ose zvogëluese.

Rreziku Operacional

Reflektohet si rrezik për rezultatin financiar dhe pasurin e organizatës për shkak të çështjeve të personelit, procedurave të pamjaftueshme dhe menaxhimin e pamjaftueshme të sistemeve të informacionit dhe për shkak të ngjarjeve të jashtme të papritura. Organizata kontrollon këto rreziqe përmes mbikëqyrjes së rreptë dhe reagimit të duhur ndaj rrezikut. Kontrolli do të thotë ndarje efektive të detyrateve, qasje të kufizuar, autorizime, dhe trajnimin e stafit në lidhje me revizionin e brendshëm. Organizata menaxhon kontrollin e rrezikut përmes përcjelljes së rregullt të rrezikut, vendosjes se procesit të duhur dhe bazës së të dhënave, mbrojtjen e informacionit dhe sigurisë nga vjedhja dhe mashtrimi.

Rreziku i Likuiditetit

Përfaqëson rrezikun e pamundësisë për të përbushur nevojën aktuale për fonde dhe përbushjen e detyrimeve afatshkurtra.

Rreziku që Organizata të hasë në vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që vijnë për shkak të mundësisë që t'i kërkohet të paguajë detyrimet e saja më herët sesa pritej.

Niveli optimal i likuiditetit bazohet në nevojën për fonde për 12 muajt e ardhshëm, statusin e likuiditetit të dy viteve të fundit, si dhe zhvillimin e kërkesave të kredisë dhe të nevojës për të hyra gjatë vitit aktual.

Pasuritë afatshkurtra janë në vlerë të njëjtë me detyrimet afatshkurt (98,253 €).

Rreziku i Tregut

Paraqet rrezikun e humbjes financiare për shkak të ndryshimeve në treg të shkaktuara nga: ndryshimet në monedhë, paqëndrueshmërin e sistemit financiar, ulja e besueshmëris së bankës, jostabiliteti financiar i partnerave, periudha e maturisë, fondeve, kohëzgjatja e procedurave, hulumtimi i tregut, çmimet konkuruese, diversiteti i produkteve, e cila çon në uljen e përqindjes. Si rrezik të tregut organizata konsideron uljen e vlerës reale ose flukseve monetare të një kërkese financiar për shkak të ndryshimeve të çmimeve të tregut.

Organizata nuk ka informacione materiale rreth ekspozimit ndaj riskut nga mjedise shumë të ndryshme ekonomike.

Organizata i ekspozohet vetëm ndaj një lloj të rrezikut të tregut brenda një mjedisë të vetëm ekonomik, kështu që nuk ka treguar ndonjë informacion të veçantë ose analizë ndjeshmërie për të treguar efektin në fitimin ose humbjen dhe ekuitet.

Deklarata mbi politikat e rendësishme të kontabilitetit-vazhdim

Donacionet

Gjatë vitit kemi njojur hyrjet nga të gjitha burimet, sipas llogarive bankare, shpalosja në shëним shpjeguese në Fq.9 Pika 1.

Të hyrat janë paraqitur në vlerë reale në datën e pranimit në bankë ose në arkë. Këto mjete kan qenë në disponim për përdorim dhe janë në para, në shërbime apo artikuj të ndryshëm.

Donacionet nuk janë njojur në tërsi, pasi që nuk janë shpenzuar, pra janë trajtuar si të hyra të shtyra që mbesin për tu shfrytëzuar për periudhën e ardhshme.

Shpenzimet

Shpenzimet janë njojur në pasqyrën e shpenzimeve kur është kriuar ulje në përfitimet ekonomike që lidhet me ulje të një aktivi ose rritje të një detyrimi dhe kur ka pas mundësi të matet me besueshmëri. Shpenzimet grupohen në pasqyrën e të ardhurave sipas funksionit të tyre. Njojja e shpenzimeve ka ndodh njëkohësisht me njojen e një rritje në detyrimet ose me një ulje në pasuri.

Njihen me kostot e tyre historike, ato janë të shprehura në shumën reale kur shpenzimet kanë ndodhur.

Shpenzimet janë kalkuluar në nivelin e çmimeve të tregut.

Shpenzimet janë të mbështetura me dokumentacion original, siç janë faturat, kontratat, listpagesat dhe pasqyra bankare.

Shpenzimet direkte në projekte, mbulojn 43% të të gjitha shpenzimeve të ndodhura gjatë kësaj periudhe.

Shpenzimet e administratës mbulojnë 15% të shpenzimeve të ndodhura gjatë kësaj periudhe.

Personeli

Kostoja e personelit u është paguar të punësuarve dhe të angazhuarve me kontrata shërbimi në përfundimin e detyrave të parapara. Pagesat janë krye mes llogaris bankare me transfere.

Përbëjn 35% të shpenzimeve administrative.

Shpenzimet programore

Kostoja e programeve është mbështetur me fatura të furnitorëve. Pagesa është e mbështetur me fatura dhe pasqyra bankare apo dokument të arkës.

Programet e zhvilluara gjatë vitit janë të paraqitura në Fq.10 pika 4. të Raportit dhe janë vazhdimësi e aktiviteteve ktyesore.

Në vitin aktual jan realizuar projekte së bashku me partner, ashtu që në raport jan paraqit si shpenzime të granteve dhe përbëjn 7% të shpenzimeve

Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative përfshijnë shpenzimet e punës së drejtimit, shërbimet ekzekutive,

Deklarata mbi politikat e rendësishme të kontabilitetit-vazhdim

financave dhe administrates, ato të procesit të punës në zyre për realizimin e qëllimeve elementare(qiraja,rryma,iji,telefoni,interneti,transporti,konsulencat, material për zyre etj.) Provizioni bankar është kalkular në bazë të pasqyrës bankare.

Shpenzimet e qirasë

Këto shpenzime i takojnë kompenzimit në emër të qirasë për objektin ku është e vendosur selia dhe ku zhvillohet aktiviteti dhe drejtimi i projekteve.

Tatimimet (mbajtja në burim) dhe kontributet

Si organizat Jo-Qeveritare, jo fitimprurse, e regjistruar sipas ligjit 06/L-43, "Për lirinë e asociimit në institucionet joqeveritare" jemi subjekt i tatimit në të ardhurat personale në Kosovë (Ligji 05/L-028). Kemi respektuar ligjin (L-03/L-084), "Mbi pensionet në Kosovë", mes kalkulimit dhe pagesës së tatimeve në të ardhura personale për punëtorë.

Nuk jemi obligues i Tatimin në të ardhura e Korporatave sipas ligjit 06/L-105 "Tatimi në të ardhurat e korporatave" pasi që nuk kemi realizuar fitim gjatë periudhës fiskale.

Kontributi pensional

Pensionet janë kalkular sipas ligjit të aplikueshëm mbi pensionet. 5% janë paguar nga i punësuari dhe 5% nga organizata.

Organizata nuk ka Fond pensional të vetin as mundësi të pagesave në formë të akcioneve, për të punësuarit, në këtë bazë nuk ka detyrime të identikuara më 31.12.

Palët e lidhura

Si transaksion me palët e lidhura, ku një palë ka mundësin e kontrollimit të palës tjetër ose ka ndikim të rëndësishëm për palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe biznesore, për transfer të kërkesave dhe obligimeve (kredive, kontratave afariste me punëtorë dhe biznese të ndërlidhura me drejtorin ose me ndonjë pronësi të përbashkët), nuk janë identifikuar.

Huazimet

Huatë njihen me vlerën e tyre nominale plus shpenzimet shoqëruese si tarifat, skontot e mundshme dhe shpenzimet tjera lidhur me huan. Huatë që janë të shprehura në monedha të ndryshme nga Eur regjistrohen me kursin historik dhe rivlerësohen me kursin e fundit të vitit në datën e raportimit.

Diferencat e këmbimit pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve qoftë si përfitim apo humbje.

Kostot e huazimit njihen si shpenzim i periudhës në të cilën ajo është krijuar.

Deklarataf mbi politikat e rendësishme të kontabilitetit-vazhdim

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe janë përfshirë në shpenzimet financiare.

Provizonet dhe detyrimet e shtyra

Të ardhurat e pashfrytëzuara-të hyrat e shtyra nga viti 2019 (34,600€) në vitin 2020, u trajtuan si shtesë e të hyrave të vitit, kurse ato të findit të vitit 2020. (97,985€) janë treguar si të hyra të shtyra në fund të vitit.

Krahasuar me vitin 2019 tregojn rritje për 63,386€.

Rezervat

Nuk kemi nda rezerva financiare gjatë kësaj periudhe.

Dividenta

Si OJQ jo-fitimprurëse, nuk kemi dekluar shuma të dividentëve të njohur si shpërndarje neto gjatë periudhës dhe vlerën përkatëse për aksion.

Zotimet

Nuk ka zotime që lidhen me shpenzimet kapitale, lisingun financier ose operativ.

Pasuritë dhe obligimet kontingjente

Nuk kemi raste të evidentuara të gjykatës ose depozita lidhur me organizatën, drejtorët ose punëtorët e saj që mund të rezultojë me detyrime në të ardhmen.

Ngjarjet pas datës së përfundimit të periudhës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes përfshijnë të gjitha ngjarjet deri në datën e autorizimit të pasqyrave financiare për publikim.

Si ngjarje me ndikim që rritë pasigurinë dhe është duke ndodhur, konsiderojmë përhapjen e pandemisë COVID-19 që ka shkaktuar kufizim në lëvizjen e njerëzve dhe kufizim të grumbullimeve dhe aktiviteteve. Qeveria ka marrë një sërë vendimesh dhe ka ndaluar përkohësisht operimin e disa veprimtarive ekonomike dhe disa aktiviteteve.

Kjo krizë pritet të ketë efekte të rëndësishme ekonomike për subjektet, qoftë për shkak të kufizimeve në prodhim, tregti, konsum dhe shërbime, ose për shkak të kufizimeve në qarkullim.